



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1488, datë 10.01.2011

Për

“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin nr. 1449, datë 12.11.2010, të KD të AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve INFO-Telecom sh.p.k dhe AMC sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.01.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin nr. 1449, datë 12.11.2010, të KD të AKEP, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve INFO-Telecom sh.p.k dhe AMC sh.a,

BAZA LIGJORE:

1. Neni 120, i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Nenet 66-104 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;

4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918
6. Vendimin nr. 1449, datë 12.11.2010, të KD të AKEP për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve INFO-Telecom sh.p.k dhe AMC sh.a”

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimi nr. 1449, datë 12.11.2010, të KD të AKEP, për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve INFO-Telecom sh.p.k dhe AMC sh.a,
2. Shkresa e INFO-Telecom nr. ML18111001Prot., datë 18.11.2010, (nr. 3247 Prot. i AKEP, datë 18.11.2010), “Kërkesë për pezullimin e ndërhyrjes administrative për zgjidhje mosmarrëveshje ndërmjet INFO-Telecom Sh.p.k. dhe AMC sh.a. për moslidhje të Marrëveshjes së Interkoneksionit, dhe tërheqje të pretendimit për mosmarrëveshje”.
3. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**); si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipercituar,

V Ë R E N se:

1. AKEP, me Vendimin nr. 1449, datë 12.11.2010, të KD, ka filluar procedimin administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve INFO-Telecom sh.p.k dhe AMC sh.a. Sipas pikës nr. 4, të këtij vendimi palët duhet të depozitonin pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit.
2. Pala investuese administrative në këtë procedim INFO-Telecom sh.p.k., me shkresën nr. ML18111001Prot., datë 18.11.2010, (nr. 3247 Prot. i AKEP, datë 18.11.2010), ka bërë kërkesë për pezullimin e ndërhyrjes administrative për zgjidhje mosmarrëveshje ndërmjet INFO-Telecom Sh.p.k. dhe AMC sh.a. për moslidhje të Marrëveshjes së Interkoneksionit, dhe tërheqje të pretendimit për mosmarrëveshje. INFO-Telecom Sh.p.k., informon se kanë nisur bisedimet me AMC sh.a., për lidhjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit.
3. Palët përmes bisedimeve, kanë arritur dakortësinë për bashkëpunim të mëtejshëm në realizimin e lidhjes së Marrëveshjes së Interkoneksionit,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

1. Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 99 e vijues të K.Pr.A (*mbi Përfundimin e procedimit administrativ*), si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me Vendimin nr. 1449, datë 12.11.2010, të KD të AKEP, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve INFO-Telecom sh.p.k dhe AMC sh.a.
2. Të njoftohen palët e interesuara “INFO-Telecom” sh.p.k dhe “AMC” sh.a për mbylljen e procedimit administrativ.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N Ë T A R Ë:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**